

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVES – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shqipe Qerimi kryetare e kolegjit, Gani Zabeli dhe Mejreme Memaj anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Zeka, në çështjen penale kundër të akuzuarve Sh.Sh. dhe D.B. nga Komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në bashkëkryerje, nga neni 410 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë P.nr.83/2016, datë 12.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), më datë 07.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si t pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë P.nr.83/2016, datë 12.12.2016, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë me aktgjykimin P.nr.83/2016, datë 12.12.2016 të akuzuarit Sh.Sh. dhe D.B i ka shpallur fajtorë për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 410 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar: të akuzuarin Sh.Sh. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë ndërsa të akuzuarin D.B. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditë, të cilat dënime do t'i vuajnë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ku në dënimet e shqiptuara u janë llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 01.01.2013 gjer me datën 24.01.2013. Me pëlqimin e të akuzuarve dhe konform nenit 47 të KPRK-së dënimet e shqiptuara me burgim u janë zëvendësuar me dënim me gjobë, ashtu që të akuzuarit Sh.Sh. në shumë prej 900 €, gjersa të akuzuarit D.B. në shumë prej 600 (gjashtëqind) €, të cilat dënime janë obliguar t'i paguajnë në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, në të kundërtën dënimet me gjobë do t'iu llogariten nga 20 € gjobës, në një ditë burgim. Të akuzuarve në dënimet e shqiptuara me gjobë, iu është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest

shtëpiak, ku për çdo 20 € iu është llogaritur në një ditë të kaluar në arrest shtëpiak. Janë obliguar që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësorë të paguajnë shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari I.B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka ushtruar Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe atë vetëm për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarve t'iu shqiptoj dënim më të lartë me burg efektiv.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën PPA/II.nr.151/2017 datë 07.02.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime më të ashpra dhe atë me burg efektiv.

Gjykata e Apelit konform dispozitave të nenit 390 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën me kohë dhe në mënyrë të rregullt i njoftoj palët. Në seancë prezantoi i akuzuari Shefket Shukriu dhe mbrojtësi i tij av. Xh.Xh. dhe i akuzuari D.B. Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.Sh. av. Xh.Xh.i deklaroi se mbetet në tërësi pranë pretendimeve ankimore të bëra në ankesën me shkrim. I akuzuari Sh.Sh. deklaroi se e mbështet ankesën e mbrojtësit të tij dhe fjalën e tij në seancë, po ashtu thekson se në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendje të dehur, njëherit deklaroi se është penduar, se me të dëmtuarin – policin nuk i kanë raportet e acaruar dhe se premtonte se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa i akuzuari D.B. deklaroi po ashtu se ka qenë në gjendje të dehur, ka qenë festë e vitit të ri dhe me këtë rast ka pir alkool, njëherit shpreh keqardhje dhe premtonte se në të ardhmen nuk do të bie ndesh e ligjin. Prokurori i Apelit, i dëmtuari Ismet Bajrami dhe mbrojtësi i të akuzuarit D.B. av. Rr.L. edhe pse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të

gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit për dënim, në ankesën e Prokurorit pretendohet se gjykata e shkallës së parë të akuzuarve nuk iu ka shqiptuar dënimin e merituar sipas ligjit, sepse këtë dënim e zbuti deri në atë masë sa që bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen, zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethanat lehtësuese çfarë do qofshin ato assesi në rastin konkret nuk kanë guxuar të vlerësohen të asaj rëndësie që të ndikojë që dënimin e parashikuar ligjor për këtë veprë penale ta zbutë gjer në këtë nivel. Thekson se gjykata i ka marrë parasysh rrethanat lehtësues dhe rënduese, mirëpo konsideron se të gjitha rrethanat e potencuara lehtësuese nuk e kanë atë rëndësi që dënimi të zbutët gjer nën minimumin e paraparë ligjorë në një anë, ndërsa në anën tjetër nuk është gjetur asnjë rrethanë veçanërisht lehtësuese, e që deri diku do ta arsyetonte sanksionin e shqiptuar penal ndaj të akuzuarve. Andaj, Prokurori konsideron se po të vlerësoheshin të njëjtat në mënyrë të drejtë, sigurisht që sanksioni penal do të ishte tjetër dhe më i ashpër. Pra, nga të cekurat më lartë, pretendohet se me dënime të tilla nuk do të mund të parandalohet kryerja e verave penale të kësaj natyre, e që në kohët e fundit janë në rritje e sipër dhe se me dënime të tilla nuk do të mund të arrihet as qëllimi i ndëshkimit i paraparë me diapozita ligjore.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit në këtë drejtim, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarve, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit siç parashihet me dispozitat e nenit 73 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit ka marrë për bazë faktin se të njëjtit pa hamendje e kanë pranuar se kanë kryer veprën penale në fjalë, sjelljen e mire të tyre në gjykatë, janë penduar, se i akuzuari Sh.Sh. jeton nga ndihma sociale për shkak të gjendjes së varfër ekonomike, po ashtu i akuzuari D. B. e ka gjendjen e varfër ekonomike, ndërsa si rrethana rënduese ka marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer penale dhe në prani të këtyre rrethanave, gjykata e shkallës së parë të akuzuarve iu ka shqiptuar dënimin si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar. Vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit, si të drejtë dhe bazuar në ligj e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se në rastin konkret nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi më të ashpër siç pretendohet në ankesën e Prokurorit, prandaj kjo gjykatë nuk e sheh të nevojshme që edhe njëherë të bëjë vlerësimin e rrethanave në këtë drejtim. Pra, duke pasur parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, e sidomos rrethanën se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, kanë pasur sjellje korrekte në gjykatë dhe janë penduar, e duke marrë parasysh edhe faktin se në ankesën e Prokurorit nuk theksohet ndonjë rrethanë veçanërisht e re rënduese dhe e cila nuk ka qenë objekt vlerësimi nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e që do të ndikonte në një dënim më të ashpër, kjo gjykatë vlerëson se dënimet me burgim e të zëvendësuar në dënime me gjobë të cilat të akuzuarve ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, duke marrë për bazë mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe rrethanat personale të kryerësve të veprës penale janë të drejta dhe të mjaftueshme për

arritjen e qëllimit të dënimit, si dhe janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimet e shqiptuara kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tyre dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimet e shqiptuara të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVES

PA1.nr.128/17, datë 07.03.2017

Bashkëpunëtore profesionale
Ilmije Zeka

Kryetare e kolegjit
Shqipe Qerimi

Anëtarët e kolegjit:
Gani Zabeli
Mejreme Memaj